

VENDIM
Nr. 37, datë 28.7.2015

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 19, DATË 16.3.2015, TË KOMITETIT PËR ZHVILLIMIN E RAJONEVE, “PËR SHPËRNDARJEN E FONDIT PËR THIRRJEN E DYTË PËR NËNPROGRAMIN E ARSIMIT, SI DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 11, DATË 25.2.2015”, DHE SHPALLJEN E THIRRJES PËR APLIKIME PËR PROGRAMIN E ARSIMIT, PJESË E FONDIT PËR ZHVILLIMIN E RAJONEVE, PËR VITIN 2015

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 e të aneksit 3, të ligjit nr. 160/2014, datë 27.11.2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Në tabelën nr. 1, që i bashkëlidhë vendimit nr. 19, datë 16.3.2015, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, bëhen ndryshime, sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Shpalljen e thirrjes për projekte të programit të arsimit, pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve, për vitin 2015. Kjo thirrje për aplikim orientohet në përmirësimin e infrastrukturës arsimore dhe edukuese.

3. Aplikimi për fonde për financimin e projekteve në programin e arsimit, të përmendura në pikën 2, të këtij vendimi, bëhet sipas kalendarit të dhënë në shtojcën I, bashkëlidhur këtij vendimi. Institucionet aplikuese janë njësitë e qeverisjes qendrore, vendore e partneritetet rajonale, si edhe agjencitë zhvillimore. Aplikimet për projektet dërgohen sipas formatit model të përdorur për aplikim.

4. Shqyrtimi për financim bëhet për projektet e aplikuar, sipas kalendarit të dhënë në shtojcat I e II, bashkëlidhur këtij vendimi. Procedura e vlerësimit kryhet pranë sekretariatit teknik përkatës, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, si dhe pranë Sekretariatit të Përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, në Kryeministri, sipas kriterëve të dhëna në shtojcën III, bashkëlidhur këtij vendimi.

5. Ngarkohen ministri i Arsimit dhe Sportit, ministri i Financave dhe Departamenti i Programimit të Zhvillimit, Financimeve dhe Ndihmës së Huaj, në Kryeministri, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Edi Rama

Zëvendëskryeministri	Zëvendëskryetar;
Ministri i Financave	anëtar;
Ministri i Zhvillimit	
Ekonomik, Turizmit,	
Tregtisë dhe Sipërmarrjes	anëtar;
Ministri i Zhvillimit Urban	anëtar;
Ministri i Transportit	
dhe Infrastrukturës	anëtar;
Ministri i Arsimit	
dhe Sportit	anëtar;
Ministri i Shëndetësisë	anëtar;
Ministri i Bujqësisë,	
Zhvillimit Rural dhe	
Administrimit të Ujërave	anëtar;
Ministri i Kulturës	anëtar;
Ministri i Mjedisit	anëtar;
Ministri i Punëve	
të Brendshme	anëtar;
Ministri i Shtetit	
për Inovacionin dhe	
Administratën Publike	anëtar;
Ministri i Shtetit	
për Çështjet Vendore	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së	
Bashkive të Shqipërisë	anëtar;

Kryetari i Shoqatës
së Komunave të Shqipërisë anëtar;
Kryetari i Shoqatës së
Qarqeve të Shqipërisë anëtar;
Kryetari i Shoqatës për
Autonomi Vendore anëtar.

Tabela 1.

Ndryshim në tabelën 1, që i bashkëlidhë vendimit nr. 19, datë 16.3.2015

Projektit nr. 6, i ndryshon vlera e financimit për vitet 2015 dhe 2016, si dhe totalet e tabelës, si më poshtë vijon:

Nr.	Autoriteti kontraktues	Titulli i projektit	Kodi i programit	Vlera e plotë e projektit (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2015 (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2016 (në lekë)
QARKU TIRANË						
6	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Ndërtim i shkollës së mesme, Farkë e Madhe, Tiranë	9230	252,467,306	25,701,776	226,765,530
TOTALI				395,317,380	97,126,815	298,190,565

SHTOJCA I

KALENDARI ME AFATET E APLIKIMIT DHE VLERËSIMIT TË PROJEKTEVE

Afati	Institucioni përgjegjës	Aktiviteti
Botimi në Fletoren Zyrtare	Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve	Hapja e thirrjes për financim të projekteve në programin e arsimit, sipas drejtimeve të përcaktuara në pikën 2, të këtij vendimi.
Jo më vonë se data 25 shtator 2015	Aplikuesit sipas pikës 2, të këtij vendimi, si më sipër.	Dërgimi i aplikimeve nga aplikuesit, si më poshtë vijon: 1. Aplikimi me shkresë zyrtare (postë ose dorazi), ku dosja e plotë e aplikimit dërgohet pranë sekretariatit teknik përkatës, përkatësisht, për: Programin e arsimit: – Ministria e Arsimit dhe Sportit 2. Shkresë zyrtare drejtuar Sekretariatit të Përgjithshëm për Zhvillimin e Rajoneve, me njoftimin dhe listën e projekteve të aplikuara, të renditura sipas prioritetit.
1 (një) ditë nga mbyllja e aplikimit	Sekretariati teknik përkatës	Vlerësimi teknik e financiar i projekteve të aplikuara, sipas shkronjës “A”, të shtojcës III.
	Sekretariati teknik përkatës	Sekretariati teknik paraqet zyrtarisht pranë Sekretariatit të Përgjithshëm listën e projekteve me vlerësimin përkatës teknik dhe financiar.
1 (një) ditë nga përfundimi i vlerësimit nga sekretariati teknik	Sekretariati i Përgjithshëm i KZHR-së (Njësia e Bashkërendimit të Programeve dhe Planifikimit Strategjik)	Vlerësimi i përputhshmërisë me strategjitë përkatëse kombëtare sipas shkronjës “B”, të shtojcës III.
	Sekretariati i Përgjithshëm i KZHR-së (Njësia e Bashkërendimit të Programeve dhe Planifikimit Strategjik)	Përgatit materialet për vendimmarrje për Komitetin për Zhvillimin e Rajoneve

1 (një) ditë nga përfundimi i vlerësimit nga Sekretariati i Përgjithshëm	Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve (KZHR)	Vendimmarrje në lidhje me projektet për t'u financuar, nga thirrja e financimit për projekte në fushën e arsimit, si pjesë e FZHR-së.
--	---	---

SHËNIM.

Procesi i vlerësimit

1. Vlerësimi i projekteve të aplikuara kryhet në dy faza. Faza e parë përbën vlerësimin teknik dhe financiar të projekteve, sipas kalendarit të dhënë në shtojcën 1, bashkëlidhur këtij vendimi. Vlerësimi teknik dhe financiar i projekteve, sipas kriterëve teknike të përcaktuara, kryhet nga sekretariati teknik, i ngritur pranë ministrisë së Arsimit dhe Sportit, sipas aneksit 3, të ligjit nr. 160, datë 27.11.2015.

2. Sekretariati teknik i paraqet zyrtarisht Sekretariatit të Përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, sipas afateve të përcaktuara në shtojcën I, bashkëlidhur këtij vendimi, listën e plotë të projekteve me vlerësimin përkatës, të bërë sipas kriterëve të përcaktuara.

3. Faza e dytë e vlerësimit të projekteve bëhet sipas afateve të përcaktuara në shtojcën I, të këtij vendimi. Gjatë kësaj faze, Sekretariati i Përgjithshëm i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve kryen vlerësimin përfundimtar të projekteve, bazuar në kriteret e përcaktuara, në shkronjën "B", të shtojcës III, bashkëlidhur këtij vendimi.

SHTOJCA II

FORMATI I APLIKIMIT PËR PROJEKTET

Ky format plotësohet për të gjitha projektet

Aplikuesi (*)	Të vendoset emri i institucionit aplikues: autoriteti i qeverisjes qendrore ose vendore, autoritetet dhe agjencitë zhvillimore, institucionet e pavarura etj.
Data e aplikimit (*)	
Titulli i projektit (*)	
Programi i projektit (*)	Të përcaktohet cili është programi ku bën pjesë projekti: Programi: arsimit
Nënprogrami i projektit (*)	Të përcaktohet nënprogrami i projektit: Arsimi bazë, i mesëm, i lartë
Data e fillimit të projektit (*)	
Data e mbarimit të projektit (*)	
Përshkrimi i projektit (*)	Të bëhet përshkrim i detajuar i projektit të propozuar, duke përmbytur informacionin e mëposhtëm, por jo vetëm: - Vendndodhja e objektit të investimit; - Përshkrimi i kushteve të objektit ekzistues (nëse ka) dhe terrenit, si dhe nevojës për këtë projekt; - Përshkrimi i punimeve/ndërrhyrjeve shtesë (sistem ngrohjeje, mur rrethues etj.) në objektin ekzistues (nëse ka); - Cilat janë problemet që adreson ky projekt dhe shkalla e ndikimit të tij; - Risqet për zbatimin e tij; - Informacion i qartë në lidhje me pronësinë e tokës (nëse parashikohet ndërtimi i një objekti të ri), si edhe dokumentacioni përkatës (harta përkatëse kadastrale etj.).
Qëllimi dhe objektivat (*)	Të paraqitet qëllimi i përgjithshëm i projektit, si dhe objektivat specifike të tij.
Numri i përfituesve (*)	Të jepet numri i popullsisë që përfiton drejtpërdrejt dhe tërthorazi nga zbatimi i projektit në total. Vlera e dhënë të shoqërohet me shpjegim për secilën kategori përfituesi.
Rendi prioritar (*)	Në rastet e aplikimit në më shumë se 1 projekt për të njëjtin program, renditini projektet sipas prioritetit/nevojës për ndërhyrje (numri 1, për shumë prioritar; numri 2, për më pak prioritar e kështu me radhë).
Qëndrueshmëria e projektit (*)	Të përshkruhet në mënyrë analitike, nëse aplikuesi parashikon për këtë projekt: Koston për mirëmbajtjen e projektit, pas zbatimit të tij; Nëse po, specifikoni sa parashikohen, si do të sigurohen etj.

Fondet e kërkuara nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve (*)	Në rast se projekti nuk ka bashkëfinancim nga njësitë qendrore, njësitë vendore apo nga donatorë, kostoja që kërkohej është e njëjtë me koston totale të projektit.
Kontributi në rast bashkëfinancimi nga njësitë e qeverisjes vendore	Paraqitni nivelin e bashkëfinancimit, në rast se projekti ka bashkëfinancim nga njësitë qendrore, vendore apo nga donatorë. Bashkëfinancim konsiderohet edhe vlera e supervizimit dhe kolaudimit të projektit, e cila nuk mbulohet nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve.
Financim nga donatorë	Nëse ka financim nga donatorë.
Financime të tjera	Nëse ka burime të tjera financimi.
Kostoja totale e projektit (*)	
Projekti ka një analizë kosto-përfitim të cilësisë së mirë (opsionale)	Po/jo
Përmbledhje e analizës kosto-përfitim	Të paraqitet një përmbledhje e shkurtër e analizës kosto-përfitim, nëse ka një të tillë.
Projekti ka një vlerësim të ndikimit në mjedis të cilësisë së mirë (opsionale)	Po/jo
Përmbledhje e vlerësimit të ndikimit në mjedis	Të paraqitet një përmbledhje e shkurtër e vlerësimit të ndikimit në mjedis, nëse ka një të tillë.
Përshkrim për gatishmërinë e projektit për zbatim (*)	Të përshkruhet nëse projekti është gati për zbatim (pra, nëse i disponon të gjitha dokumentet që nevojiten për zbatimin e tij) dhe koha kur mund të fillojë dhe të përfundojë procedura e prokurimit publik dhe kur mund të fillojë dhe të përfundojë zbatimin i punimeve.
Dokumentet e miratimit të projektit nga njësitë e qeverisjes vendore (*)	Të paraqiten dokumente për të vërtetuar nëse projekti paraqet: - Vendim të bordit kolegjial drejtues (në rast se është agjenci zhvillimi); - Vendim të këshillit drejtues të njësisë vendore (komunës/qarkut/bashkisë); - Është përfshirë në listën e miratuar nga këshilli i njësisë vendore për financim (kur është parashikuar bashkëfinancimi); - Është në listën e projekteve/nevojave të parashikuara nga institucioni përkatës (nëse aplikohet nga institucion qendror). Për të gjitha rastet e sipërpërmendura të cilësohet numri dhe data e miratimit të vendimit, si dhe të bashkëngjitet një kopje e vendimit/dokumenteve të tjera.
Planifikimi vendor, ndërvendor, rajonal (*)	Të paraqitet dhe të specifikohet nëse projekti është: - pjesë e strategjisë vendore (të bashkisë apo komunës); - pjesë e strategjisë së zhvillimit të qarkut; - pjesë e planeve të investimeve kapitale të njësisë së qeverisjes vendore; - pjesë e një plani zhvillimor strategjik (të specifikohet se ç'loj plani). Për të gjitha rastet e sipërpërmendura të cilësohet viti i miratimit të dokumentit strategjik apo planit, si dhe të citohet dokumenti.
Dokumentet teknike (*)	Të sqarohet nëse projekti përmban: - projektin teknik; - preventivin; - argumentimin teknik; - përlogaritje/parashikim të kostove të mirëmbajtjes së investimit.

(*) Fushat me këtë simbol janë të detyrueshme për t'u plotësuar.

SHËNIM

Dërgimi i aplikimeve, sipas afatit:

1. Aplikimet për projekte duhet të dërgohen:

- Me shkresë zyrtare (postë), së bashku me dosjen e plotë të aplikimit pranë sekretariatit teknik përkatës (Ministria e Arsimit dhe Sportit).

2. Përveç aplikimit si më lart, institucionet aplikuese duhet t'i dërgojnë një shkresë zyrtare Sekretariatit të Përgjithshëm për Zhvillimin e Rajoneve, pranë Këshillit të Ministrave. Shkresa zyrtare përmban njoftimin për dërgimin e aplikimit pranë sekretariatit teknik përkatës, si dhe listën e projekteve të aplikuara. Projektet e aplikuara duhet të jenë të renditura sipas prioritetit që i ka dhënë institucioni aplikues.

SHTOJCA III

KRITERET E VLERËSIMIT TË PROJEKTEVE

A. Kriteret e vlerësimit teknik

Këto kritere përdoren nga sekretariatet teknike për të vlerësuar teknikisht projektin dhe në bazë të tyre kryhet vlerësimi, maksimalisht, me 70 pikë i një projekti.

Kriteret 1 dhe 2 detajohen në nënkriteret përkatëse teknike, nga sekretariati teknik i ngritur pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, sipas aneksit 3, të ligjit nr. 160, datë 27.11.2014. Këto kritere kanë të bëjnë me standardet teknike të domosdoshme për të kualifikuar për vlerësim një projekt zbatimi.

Kriteret për vlerësimin teknik të projekteve janë, si më poshtë vijon:

1. Cilësia teknike dhe kostimi, vlerësimi financiar i projekteve të propozuara nga njësitë e qeverisjes vendore. Ky kriter nënkupton se projektet, që teknikisht janë detajuar saktë dhe qartë, si dhe ato projekte, ku kostimi i projektit dhe preventivi është përpiluar dhe vlerësuar saktë nga aplikanti, me çmimet referencë sipas buletineve etj., do të vlerësohen për financim, duke pasur një vlerësim nga 0 deri në, maksimalisht, 20 pikë.

2. Niveli i ulët i riskut për zbatimin e projektit, bazuar në elemente të përshkrimit të projektit që orientojnë mbi rriskun e mundshëm në prokurimin publik, zbatimin me sukses të projektit dhe përdorimin në kohë të fondeve publike. Ky kriter vlerësohet me 0 deri në, maksimalisht, 10 pikë.

3. Ndikimi i projektit në shërbimet publike ndaj qytetarëve dhe biznesit, cilësinë e jetës, shëndetin, arsimimin dhe zhvillimin ekonomiko-social, në përmirësimin e perspektivës për punësim dhe përdorimit dhe zhvillimit të aftësive, që vlerësohet me 0 deri në, maksimalisht, 20 pikë, duke plotësuar dy prej komponentëve, si më poshtë vijon:

- prek qendërqarkun dhe ndikon në zhvillimin ekonomike vendore, konsolidimin e strukturës ekonomike të zonave apo qarqeve të ndryshme. Për këtë komponent vlerësimi përfshin 0 deri në 5 pikë.

- ka rëndësi të veçantë nga pikëpamja turistike dhe potenciale për ekonomi lokale dhe zona të përmirësuara biznesi. Për këtë komponent, vlerësimi bëhet me 0 deri në, maksimalisht, 5 pikë.

- rivitalizimi dhe rikualifikimi urban, ku synohet përmirësimi në qendra të mëdha urbane, përmes nxitjes së bërthamave social-kulturore, të shërbimeve publike, të trashëgimisë kulturore etj. Për këtë komponent, vlerësimi bëhet me 0 deri në, maksimalisht, 5 pikë.

- projekti ndikon në rehabilitimin mjedisor dhe krijimin e korridoreve të gjelbër ndërqytetas, si dhe në zona turistike. Për këtë komponent vlerësimi bëhet me 0 deri në, maksimalisht, 5 pikë.

4. Numri i përfituesve në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe/ose të tërthortë nga projekti. Vlerësimi sipas këtij kriteri kryhet në varësi të numrit të institucioneve/përdoruesve/shërbimeve që përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe/ose të tërthortë. Vlerësimi sipas këtij kriteri bëhet me 0 deri në, maksimalisht, 5 pikë.

5. Analizat apo studimet që janë kryer në lidhje me projektin, si studimi i fizibilitetit, analiza kosto - përfitim, etj. Vlerësimi sipas këtij kriteri bëhet me pikë nga 0 deri në, maksimalisht, 5 pikë.

6. Qëndrueshmëria e investimit nga projekti, që lidhet me faktin nëse janë parashikuar kosto mirëmbajtjeje për projektin në vazhdimësi, të cilat do të merren përsipër nga institucioni aplikues. Vlerësimi sipas këtij kriteri bëhet me 0 deri në, maksimalisht, 5 pikë.

7. Niveli i bashkëfinancimit nga njësitë e qeverisjes qendrore apo vendore apo fondet e donatorëve. Vlerësimi sipas këtij kriteri bëhet me pikë nga 0 deri në, maksimalisht, 5 pikë.

B. Kriteret e vlerësimit strategjik

Këto kritere përdoren nga sekretariati i përgjithshëm për të kryer vlerësimin e projektit nga pikëpamja e të qenit projekt prioritar, në nivel vendor, qarku apo kombëtar, duke vlerësuar një projekt me, maksimalisht, 30 pikë, si më poshtë vijon:

1. Shkalla e përputhshmërisë me përparësitë/strategjitë vendore dhe/ose të zhvillimit të nivelit

rajonat/kombëtar dhe ndikimi në zhvillimin lokal/rajonat/kombëtar. Niveli i potencialit për nxitjen e ekonomive lokale dhe zona të përmirësuara të biznesit; krijimi i poleve të zhvillimit urban të qendërfaqeve. Vlerësimi për këtë kriter përfshin nga 0 deri në, maksimalisht, 15 pikë.

2. Potenciali për zhvillim, qëndrueshmëri dhe për tërheqjen për investime të reja dhe/apo faza të reja të zhvillimit që paraqet projekti. Niveli i ndikimit për zhvillimin e qëndrueshëm në mjedis. Vlerësimi për këtë kriter përfshin nga 0 deri në, maksimalisht, 15 pikë.